



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 01/170

Datë: 14.02.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shkurt 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes së garancisë për linjën kreditore për Fondin e Sigurimeve të Depozitave në Kosovë nëpërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Projektligjin nga pika 1. e këtij vendimi t'ia procedojë për shqyrtim dhe miratim Kuvendit të Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 02/170

Datë: 14.02.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shkurt 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal për iniciimin dhe zhvillimin e procedurave ligjore për themelimin e Komunës së re të Hogoshtit, bazuar në Kreun II të Ligjit për Kufijtë Administrativ të Komunave, dhe kërkesën e parashtruar nga Bashkësia e Fshatit Hogosht.
2. Obligohet Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal të ndërmerr të gjitha veprimet ligjore që ndikojnë në themelimin Komunës së re të Hogoshtit, bazuar në legjislacionin e zbatueshëm për vetëqeverisje lokale në Republikën e Kosovës.
3. Ministrinë dhe komunat të cilat ndërlidhen me procesin e zbatimit të kushteve ligjore për themelimin e kësaj komune të re, janë të obliguara të ofrojnë përkrahje të vazhdueshme, sipas kërkesës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 03/170

Datë: 14.02.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 3 të Ligjit nr.03/L087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjit nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shkurt 2014, mori:

**V E N D I M**

1. I bartet në shfrytëzim të përhershëm, pa kompensim, për interes publik, prona e KEK-ut në zonën kadastrale Milloshevë, ngastrat 836-4 e ndarë nga sipërfaqja bazë (ngastra nr.836-1) bazuar në elaboratin e Vendimit Preliminar Nr. 04/62 të datës 22 shkurt 2012 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Ndërmarrjes Publike KRU-Prishtina Sh. A. me qëllim të ndërtimit të Fabrikës së ujit në fshatin Shkabaj.
2. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 04/170

Datë: 14.02.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shkurt 2014, mori:

**V E N D I M**

**Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr. 09/115 të datës 13.02.2013**

1. Plotësohet Grupi Punues për menaxhimin e projektit "Sistemi i Integruar Informativ për Zhvillim Ekonomik" me përfaqësuesit e këtyre institucioneve:
  - 1.1. Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë - anëtar;
  - 1.2. Ministria e Infrastrukturës - anëtar;
  - 1.3. Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor - anëtar;
  - 1.4. Ministria e Punëve të Brendshme - anëtar;
  - 1.5. Ministria e Punëve të Brendshme/Policia e Kosovës - anëtar;
  - 1.6. Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale - anëtar;
  - 1.7. Ministria e Shëndetësisë - anëtar.
2. Me qëllim të vazhimit të fazës së dytë të Sistemit të Integruar Informativ për Zhvillim Ekonomik nëpërmjet integritit, mirëmbajtjes dhe shkëmbimit të të dhënave për zhvillimin ekonomik të Kosovës, Grupi punues ka për detyrë:
  - 2.1. Të vazhdoj projektin e Sistemit të Integruar Informativ për Zhvillim Ekonomik;
  - 2.2. Të finalizoj Termat e Referencës për fazën e dytë të projektit;
  - 2.3. Të monitoroj dhe drejtojë implementimin e aktiviteteve të projektit.
3. Ministria e Zhvillimit Ekonomik bën koordinimin dhe mbikëqyrjen e implementimit të këtij projekti.
4. Obligohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe Institucionet tjera të përfaqësuara në këtë Grup Punues për zbatimin e këtij vendimi.

5. Vendimi hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit.

  
Hashim THAÇI

\_\_\_\_\_  
Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 05/170

Datë: 14.02.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 11 dhe nenit 45 të Ligjit nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shkurt 2014, mori:

**V E N D I M - P Ë R F U N D I M T A R**

1. Aprovohen shpronësimet për interes publik të pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i Pallatit të Drejtësisë, Zona Kadastrale Qagllavicë, Komuna e Prishtinës dhe shpronësimi i përhershëm dhe me vënien e të drejtës së servitutit për interes publik i pronave të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesve të interesit të cilat preken nga ndërtimi i largpërçuesit (shtyllave elektrike) për nevoja të Burgut të Sigurisë së Lartë, Zona Kadastrale Batllavë, Dyz, Gërdovc dhe Tërnavë, Komuna e Podujevës, sipas tabelave të bashkangjitur këtij vendimi.
2. Brenda 5 (pesë) ditëve të punës pas nxjerrjes së këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH, i dërgojnë vendimin subjektit kërkues dhe personave të tjerë të identifikuar në tabelat e përcaktuara në pikën 1. të këtij vendimi.
3. Brenda 10 (dhjetë) ditëve të punës pas miratimit të këtij vendimi, Departamenti i Shpronësimit/MMPH bënë shpalljen e vendimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë.
4. Pjesë integrale e këtij vendimi është akti i vlerësimit dhe tabelat të bashkangjitura këtij vendimi në të cilat është përcaktuar shumat e kompensimit për ata pronarë apo zotërues të interesit, të drejtat pronësore ose interesat e ligjshme të cilëve i'u janë prekur nga procesi i shpronësimit.
5. Kundër këtij vendimi subjektet kanë të drejtë të paraqesin ankesë brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike në gjykatën kompetente, vetëm për kundërshtimin e shumës së kompensimit të përcaktuar në këtë vendim, subjekti kërkues, cilido person i cili është pronar ose zotërues i interesit, në pronën e paluajtshme ose të

drejtat pronësore të prekura nga ky vendim, si dhe çdo person i interesuar i cili ka një interes legjitim të drejtpërdrejtë dhe material në pronën e paluajtshme e cila është objekt i vendimit përfundimtar, pavarësisht nëse është identifikuar apo jo në tabelat e bashkangjitura të këtij vendimi.

6. Brenda 2 (dy) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit, Departamenti i Shpronësimit në kuadër të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor do të paguajë plotësisht shumën e kompensimit të shpronësimit, të përcaktuar në këtë vendim.
7. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh të madh në Kosovë.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 06/170

Datë: 14.02.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shkurt 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Raporti për zbatimin e Planit të veprimit për zbatimin e Strategjisë së Reformës së Administratës Publike për periudhën maj 2012 - dhjetor 2013.
2. Obligohet Ministria e Administratës Publike dhe Institucionet tjera kompetente për zbatimin e obligimeve që dalin nga Raporti nga pika 1. e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë





**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 07/170

Datë: 14.02.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shkurt 2014, mori:

**V E N D I M**

**Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit nr.09/121 të datës 27 mars 2013.**

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 1. e vendimit nr.09/121 të datës 27 mars 2013 si në vijim: shtojca 1. të dhënat për ndarjen e grandeve të Përgjithshme në komunat Leposaviq, Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok dhe Zveqan, mbetet në fuqi sipas ligjit për Financat e Pushtetit Lokal nr. 03/L-049 dhe do të vlejë vetëm për vitin 2014, ndërsa nuk do të ketë efekte për vitet pasuese.
2. Në vitin 2014 është ndarë buxhet shtesë për të kompensuar ndryshimet në të dhënat e popullsisë për këto komuna, ky vendim nuk do të ketë kosto shtesë buxhetore.
3. Agjencia e Statistikave në bashkëpunim me organet e pushtetit lokal të filloj procedurën e regjistrimit të popullsisë në komunat e cekura në pikën 2. të vendimit dhe të dhënat nga regjistrimi do të reflektohen në aneksin e Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal dhe të përdorën në procesin e buxhetit për vitin 2015.
4. Obligohet Ministria e Financave dhe të gjitha institucionet kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAÇI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 08/170

Datë: 14.02.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shkurt 2014, mori:

**V E N D I M**

**Për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të Qeverisë numër 03/82 të datës 04.07.2012**

1. Ndryshohet pika 9. e vendimit të Qeverisë numër 03/82 i datës 04.07.2012 për Themelimin e Strukturave Institucionale për koordinimin e zbatimit të Udhërrëfyesit për Liberalizim si në vijim: "Sekretariati për Liberalizimin e Vizave (tutje Sekretariati) përbëhet nga Ministria e Integritimit Evropian dhe Departamenti për Integrim Evropian dhe Koordinim të Politikave, në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme".
2. Obligohen institucionet kompetente për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 09/170

Datë: 14.02.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 16 të Ligjit nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, nenit 7 të rregullores nr. 33/2012 për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civil, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shkurt 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Aprovohet kërkesa Ministrisë së Administratës Publike për dhënien e shtesës mbi pagën bazë për kushtet specifike të punës për stafin përkatës në Departamentin e Mjekësisë Ligjore në Ministrinë e Drejtësisë në shumën prej 30% më shumë për çdo orë të punës e cila i është ekspozuar rrezikut të punës.
2. Obligohet Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Administratës Publike për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THACI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

Nr. 10/170  
Datë: 14.02.2014

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës dhe të Rregullores nr. 06/2010 për procedurat e emërimit në pozita të larta drejtuese në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësive administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 14 shkurt 2014, mori:

**V E N D I M**

1. Z. Ragip Gjoshi, emërohet Drejtor i Përgjithshëm në Agjencinë për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe për të Rritur në Ministrinë e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.
2. Mandati i të emëruarit nga pika 1. e këtij vendimi zgjat tre (3) vjet.
3. I emëruari nga pika 1. e këtij vendimi kryen të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara me legjislacionin në fuqi.
4. Obligohet Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë për zbatimin e këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Hashim THAGI

Kryeministër i Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë